



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 03, Datë 14.06.2016


PËR
MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRUAR NDËRSEKTORIAL PËR ZONËN
EKONOMIKE TIRANË-DURRËS

Në mbështetje të neneve 7, 8, 17 dhe 25 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar, të Vendimit Nr. 671 datë 29.07.2015 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit", të Vendimit Nr. 2 datë 08.04.2014 të Këshillit Kombëtar të Territorit "Për miratimin e nismës për hartimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës" si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit", me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës, pjesë e të cilit janë dokumentet e mëposhtme:
 - a) Relacioni i Planit;
 - b) Materiali hartografik:
 - i. Harta e Potencialeve Ekonomike dhe Turistike;
 - ii. Harta e Sistemit Urban;
 - iii. Harta e Sistemit Bujqësor;
 - iv. Harta e Sistemit Infrastrukturor;
 - v. Harta e Sistemit Natyror dhe Ujor.
2. Gjatë hartimit të planeve të tjera sektoriale kombëtare, planeve të detajuara për zona të rëndësishme kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislati në fuqi dhe nga Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.

3. Ngarkohen Ministritë përgjegjëse dhe të gjitha autoritetet e tjera shtetërore, sipas fushave të përgjegjesisë, përfshirë Agjencinë e Zhvillimit Rajonal 2, Agjencinë e Zhvillimit të Territorit, Bashkitë Tiranë, Durrës, Kamëz, Vorë, Shijak, Krujë për zbatimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës, si dhe për bashkërendimin e punës në zbatim të këtij plani me AKPT-në.
4. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë, gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor në përputhje me përcaktimet e Planit të Integruar Ndërsektorial për zonën ekonomike Tiranë-Durrës.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



The image shows a handwritten signature in black ink, which appears to be 'Edi Rama', written over a blue circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQERISE' at the top, 'MINISTRI I ZVILLIMIT TË TERRITORIT' on the right side, and 'EDI RAMA' in the center. The stamp also features the coat of arms of Albania. The signature is written in a cursive style, with a long horizontal stroke extending to the right.

ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMENI

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETAR I KKT

LEDIA TOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

